



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL PËR EFEKT MARRJEN E  
SHKALLËVE TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE TË LËNDËVE DHE  
PRAKTIKAVE PROFESIONALE NË ARSIMIN PROFESIONAL  
2016**

### 1) HYRJE

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të arsimit profesional është hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit – IZHA për t’u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të kulturës profesionale të arsimit profesional për t’u përgatitur për testimin kombëtar për marrjen e shkallëve të kualifikimit.

Programi është zhvilluar duke iu përgjigjur kërkesave që MAS-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- dokumentet zyrtare<sup>1</sup> të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore – edukative të mësuesve;
- dokumentacionin në nivel shkolle;
- aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë në mësimdhënie-nxënie në përgjithësi si dhe të arsimit profesional në veçanti;
- aspekte të etikës dhe komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

### 2) QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të arsimit profesional është hartuar për të mbështetur dhe nxitur zhvillimin profesional të tyre. Programi është hartuar nga grupi i punës duke mbajtur parasysh përmbushjen e dy qëllimeve kryesore:

- *Së pari*, të ofrohet si një program orientues për t’u ardhur në ndihmë Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave të Arsimit të rretheve si dhe të gjithë mësuesve të kulturës profesionale të arsimit profesional (në arsimin parauniversitar) për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese në bazë rrethi. Në këtë aspekt programi mund të plotësohet nga DAR/ZA-të përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete.

<sup>1</sup> Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MAS që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

- *Së dyti*, si një program i detyruar veçanërisht për mësuesit që këtë vit do të marrin shkallët e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje gjithëvjetoje, për të përballuar me sukses kërkesat që ka testimi kombëtar që bëhet për mësuesit e arsimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit.

Programi synon:

- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës së arsimit profesional .
- Rritjen e aftësive dhe kompetencave profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e efektivitetit të procesit mësimor, drejt një mësimdhënieje të suksesshme.
- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për domosdoshmërinë zbatimit të koncepteve dhe ligjësive shkencore të lëndës në praktikë, në përputhje me specifikat e kualifikimit profesional, moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim.
- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë.
- Rritjen e aftësive të mësuesve në drejtim të zbatimit me saktësi të rregullave drejtshkrimore të shqipes.
- Realizimin në praktikë nëpërmjet demonstrimit konkret të aftësive të fituara, e në mënyrë të veçantë nëpërmjet vlerësimit të arritjeve përmes testimit.

### **3) PËRMBAJTJA E PROGRAMIT**

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të kulturës profesionale të arsimit profesional është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional të përmendura më sipër, për të cilat testohen mësuesit. Për secilën fushë janë renditur njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë mësuesi i arsimit profesional që të përmbushë me sukses rubrikat e testimit.

Programi është ndërtuar edhe duke patur si pikënisje standardet e përgjithshme të mësuesit. Përshkallëzimi i kompetencave profesionale që lidhen me secilën fushë të testimit do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë nevojat e tij si dhe çështjet në të cilat duhet të thellohet më shumë.

**FUSHA : DOKUMENTET ZYRTARE TË PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE PËR**

**ARSIMIN PROFESIONAL**

<b>Kompetenca:</b>	<b>Literatura</b>
<p><b>Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe dokumentacionit shkollor</b></p>	
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><b>Mësuesi i arsimit profesional duhet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të shpjegojë Ligjin për Arsimin Parauniversitar të ndryshuar, duke interpretuar dhe referencat për arsimin profesional;</li> <li>• të interpretojë Ligjin aktual të Arsimit dhe Formimit Profesional të ndryshuar;</li> <li>• të interpretojë aktet nënligjore për arsimin dhe formimin profesional;</li> <li>• të shpjegojë referencat që ka për mësuesit Kodi i punës;</li> <li>• të shpjegojë ndryshimet që rrjedhin nga kalimi i përgjegjësisë për AP, nga MAS te MMSR;</li> <li>• të interpretojë referencat në Dispozitat normative për AP dhe profesionin e mësuesit;</li> <li>• të dallojë elementet kyç të Strategjisë së Punësimit dhe Aftësive 2014-2020 dhe të planit përkatës së veprimtimit;</li> <li>• të shpjegojë veçoritë e strukturës së AP;</li> <li>• të shpjegojë strukturën institucionale dhe organizative të AP;</li> <li>• të përshkruajë statusin e mësuesit të AP, funksionet dhe detyrat e tij;</li> <li>• të shpjegojë kuptimin e parimeve, udhëzimeve, rekomandimeve dhe formulimeve të tjera që barten në dokumentet bazë të arsimit profesional;</li> <li>• të shpjegojë me shembuj zbatimin praktik në punën e përditshme të rekomandimeve, udhëzimeve dhe formulimeve të tjera që barten në dokumentet bazë të arsimit dhe arsimit profesional;</li> <li>• të shpjegojë me shembuj rastet e zbatimit të dokumenteve zyrtare në lidhje me partneritetin social në AP.</li> <li>• të interpretojë dhe përdorë dokumentet administrative në shkolla profesionale;</li> <li>• të përdorë dokumentacionin që lidhet me procesin mësimor, skeletkurrikulat, kurrikulat shkollore (planet, programet, ditari etj),</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar i ndryshuar me Ligjin 63/2014</li> <li>• Ligji Nr. 69/2012 për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.</li> <li>• Urdhri për miratimin e Dispozitave Normative për arsimin parauniversitar (DN), Nr 343, datë 19.08.2013.</li> <li>• Udhëzim Nr. 23, dt. 08.08.2014 për vitin shkollor 2014-2015 në sistemin arsimor parauniversitar.</li> <li>• Udhëzimi Nr. 44, datë 16.10.2014 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 21 datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore – edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”.</li> <li>• Udhëzimi Nr.1 datë 12.01.2015 “Për zhvillimin e provimeve të maturës shtetërore 2015”.</li> <li>• Udhëzim Nr. 5 datë 25.02.2013 “Për standardet e mësuesit”.</li> <li>• Udhëzimi Nr. 26 datë 15.08.2015 “Zhvillimin Profesional të Punonjësve Arsimorë”.</li> <li>• Udhëzimi Nr 2 datë 12.02.2015 “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”.</li> <li>• Udhëzimi 5 dhe 6 i MMSR.</li> <li>• Strategjia e Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2014-2020. www.mmsr.al</li> <li>• Dokumentacion administrativ, skeletkurrikula, formate programesh shkollore, ditari etj.</li> <li>• Karta e performancës së shkollës.</li> <li>• Standardet e shkollës si qendër komunitare.</li> </ul>

instrumentet e vlerësimit, evidencat (regjistrat), certifikatat etj.	
----------------------------------------------------------------------	--

**FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK  
NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE**

Kompetenca I	Literatura
<b>Zotërimi i njohurive didaktike dhe psiko-pedagogjike specifike të AP</b>	
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><b>Mësuesi i arsimit profesional duhet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të shpjegojë konceptet bazë të AP (arsim, arsim profesional, profesion, tregu i punës, kualifikim profesional, pedagogji, psikologji, didaktikë, metodikë, përmbajtje mësimore, objektiv mësimor, metodë mësimore, stili i të nxënit, media mësimore, vlerësimi i nxënësve, instrument vlerësimi, njohuri, shprehi, qëndrim (sjellje), kompetencë profesionale, kompetencë kyçe, të nxënit, të nxënit gjatë gjithë jetës, kurrikul, program mësimor, lëndë mësimore, modul mësimor, standard mësimor, krediti etj);</li> <li>• të japë shembuj të koncepteve dhe termave bazë nga lënda/fusha profesionale përkatëse;</li> <li>• të përshkruajë veçoritë e të mësuarit të njohurive;</li> <li>• të përshkruajë veçoritë e të mësuarit të shprehive praktike;</li> <li>• të përshkruajë mënyra të zbatimit praktik të konceptit të sipërmarrjes në lëndët apo modulet profesionale;</li> <li>• të japë shembuj të zbatimit të partneritetit social në AP.</li> <li>• Për një njësi mësimore nga lënda/moduli përkatës: <ul style="list-style-type: none"> <li>- të hartojë objektivat mësimore;</li> <li>- të përzgjedhë përmbajtjet/veprimtaritë mësimore;</li> <li>- të përzgjedhë metodat mësimore;</li> </ul> </li> <li>• të përshkruajë aspekte të motivimit të nxënësve;</li> <li>• të shpjegojë veçoritë e stileve të të nxënit;</li> <li>• të përshkruajë veçoritë e perceptimit pamor dhe dëgjimor në procesin mësimor;</li> <li>• të analizojë në mënyrë kritike dhe krijuese, objektiva mësimore, përmbajtje mësimore dhe</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fjalori i Arsimit dhe Formimit Profesional.</li> <li>• Fjalor për kurrikulën, planifikimin, formimin.</li> <li>• Broshurat “Arsimi dhe Formimi Profesional”, Nr. 1-12. ., <a href="http://www.akafp.gov.al">www.akafp.gov.al</a></li> <li>• Broshura “Të mësuarit me projekte në Arsimin Profesional”.</li> <li>• Broshura “Standardet e mësimit në AFP”.</li> <li>• Broshura “Reformimi i kurrikulës së AP”.</li> <li>• “Udhëzues metodologjik për hartimin e kurrikulave të AFP në Shqipëri”</li> <li>• Literaturë që ka në fokus metodat e mësimit ndërvetpruese, me në qendër nxënësin.</li> <li>• Udhëzues metodologjikë për mësimit në fushën e arsimit profesional.</li> <li>• Udhëzues dhe materiale mbështetëse që orientojnë për hartimin e objektivave të orës së mësimit, përgatitjen e ditarit të mësimit, organizimin e orës së mësimit.</li> <li>• Faqja e internetit të AKAFPK (<a href="http://akafp.gov.al">akafp.gov.al</a>)</li> </ul>

<p>metoda mësimore të dhëna për një njësi mësimore nga lënda ose moduli përkatës;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të japë shembuj nga përvoja si mësues, për motivimin e nxënësve;</li> <li>• të japë shembuj nga përvoja si mësues, për stilet e të nxënësve të veçantë dhe përshtatjen e mësimdhënies ndaj tyre;</li> <li>• të përshkruajë aspekte të menaxhimit të stresit dhe konflikteve në mësim, dhe të japë shembuj për to.</li> </ul>	
<p style="text-align: center;"><b>Kompetenca II</b></p> <p><b>Zotërimi i parimeve bazë të të mësuarit (referuar specifikave të AP)</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Literatura</b></p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><b>Mësuesi i arsimit profesional duhet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të rendisë parimet didaktike bazë;</li> <li>• të shpjegojë kuptimin e secilit prej parimeve didaktike bazë;</li> <li>• të japë shembuj të zbatimit të secilit prej parimeve didaktike bazë në procesin mësimor nga lënda/fusha profesionale përkatëse;</li> <li>• të analizojë në mënyrë kritike dhe krijuese dokumente planifikuese mësimore të dhëna, nga këndvështrimi i zbatimit të parimeve bazë të të mësuarit;</li> <li>• të përshkruajë rëndësinë e integritit të koncepteve dhe praktikave të arsimit gjithpërfshirës, të filozofisë së të nxënësve gjatë gjithë jetës, të zhvillimit të qendrushëm etj, në procesin e mësimdhënies/nxënies.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Broshurat “Arsimi dhe Formimi Profesional”, Nr. 1-12.</li> <li>- “Udhëzues metodologjik për hartimin e kurrikulave të AFP në Shqipëri”</li> <li>- Faqja e internetit e AKAFPK (akafp.gov.al)</li> </ul>
<p style="text-align: center;"><b>Kompetenca III</b></p> <p><b>Përdorimi i medieve pedagogjike</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Literatura</b></p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><b>Mësuesi i arsimit profesional duhet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të shpjegojë kuptimin për mediat pedagogjike;</li> <li>• të listojë mediat pedagogjike;</li> <li>• të tregojë veçoritë e përdorimit të medieve pedagogjike në AP;</li> <li>• të argumentojë përparësitë dhe vështirësitë e përdorimit të mediave pedagogjike në mësim;</li> <li>• të japë shembuj të përdorimit të mediave mësimore në procesin mësimor, sipas lëndës ose modulit përkatës;</li> <li>• të përzgjedhë mediet pedagogjike të përshtatshme për një njësi mësimore të dhënë,</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Broshurat “Arsimi dhe Formimi Profesional”, Nr. 1-12.</li> <li>- Fjalori i Arsimit dhe Formimit Profesional.</li> <li>- Broshura “Standardet e mësimdhënies në AFP”.</li> <li>- “Udhëzues metodologjik për hartimin e kurrikulave të AFP në Shqipëri”</li> <li>- Faqja e internetit e AKAFPK (akafp.gov.al)</li> </ul>

nga lënda/moduli përkatës; • të argumentojë përzgjedhjet e bëra.	
<b>Kompetenca IV</b>  <b>Planifikimi i procesit mësimor në AP</b>	<b>Literatura</b>
<b>Rezultatet e pritshme</b>  <b>Mësuesi i arsimit profesional duhet:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të shpjegojë kuptimin për planifikimin e procesit mësimor;</li> <li>• të shpjegojë parimet ku mbështetet planifikimi i procesit mësimor;</li> <li>• të rendisë faktorët që konsiderohen gjatë planifikimit të procesit mësimor (teorik ose praktik) dhe tregojë si ndikojnë ato në planifikim;</li> <li>• të përshkruajë veçoritë e procesit mësimor në AP;</li> <li>• të rendisë dhe shpjegojë fazat kryesore të planifikimit të procesit mësimor (teorik ose praktik);</li> <li>• të hartojë planin e një njësie mësimore (teorike ose praktike) sipas fazave kryesore dhe në përputhje me parimet bazë të planifikimit;</li> <li>• të shpjegojë planin e hartuar dhe argumentojë përzgjedhjet e bëra;</li> <li>• të analizojë në mënyrë kritike dhe krijuese planin e një njësie mësimore (teorike ose praktike) të dhënë, duke rekomanduar përmirësimet e duhura;</li> <li>• të planifikojnë projekte kurrikulare, module me qëllim.</li> </ul>	Fjalor për kurrikulën, planifikimin, formimin. - Broshura “Standardet e mësimdhënies në AFP” - Broshurat “Arsimi dhe formimi Profesional”, Nr 1 - 12. - “Udhëzues metodologjik për hartimin e kurrikulave të AFP në Shqipëri” - Faqja e internetit e AKAFPK (akafp.gov.al)
<b>Kompetenca V</b>  <b>Vlerësimi i nxënësve në AP</b>	<b>Literatura</b>
<b>Rezultatet e pritshme</b>  <b>Mësuesi i arsimit profesional duhet:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të shpjegojë kuptimin e vlerësimit të nxënësve;</li> <li>• të përshkruajë llojet e vlerësimit sipas kritereve të ndryshme;</li> <li>• të tregojë veçoritë e vlerësimit të nxënësve në AP;</li> <li>• të listojë metodat dhe instrumentet kryesore për vlerësimin e njohurive dhe për vlerësimin e shprehive praktike të nxënësve;</li> <li>• të japë shembuj të instrumenteve të</li> </ul>	- Broshurat “Arsimi dhe Formimi Profesional”, Nr. 1-12. - Fjalori i Arsimit dhe Formimit Profesional. - Broshura “Standardet e mësimdhënies në AFP”. - “Udhëzues metodologjik për hartimin e kurrikulave të AFP në Shqipëri” - Faqja e internetit e AKAFPK (akafp.gov.al)

<p>vlerësimin të nxënësve, nga lënda/moduli përkatës;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të përzgjedhë metodat dhe instrumentet e duhur të vlerësimin të nxënësve për situata të ndryshme mësimore (teorike ose praktike);</li> <li>• të shpjegojë mënyrat e organizimit të provimeve përfundimtare në AP (teorike ose praktike);</li> <li>• të hartojë instrumente të thjeshta të vlerësimin të nxënësve për nivele të ndryshme të njohurive;</li> <li>• të hartojë lloje të ndryshme instrumentesh për vlerësimin e nxënësve për nivele të ndryshme të njohurive dhe shprehive praktike nga lënda ose moduli përkatës;</li> <li>• të hartojë instrumente komplekse (rubrika) për vlerësimin e nxënësve dhe të llogarisë rezultatin e vlerësimin të nxënësve me to;</li> <li>• të hartojë një test për vlerësimin përfundimtar të njohurive të nxënësve në lëndën profesionale përkatëse;</li> <li>• të ndërtojë një plan të vlerësimin të nxënësve për një proces mësimor të dhënë (temë, kapitull, RM etj.) dhe të hartojë instrumentet përkatëse të vlerësimin;</li> <li>• të analizojë në mënyrë kritike dhe krijuese një instrument kompleks (rubrikë) vlerësimi të dhënë;</li> <li>• të analizojë rezultatet e vlerësimin të një grupi nxënësish dhe të nxjerrë konkluzionet e duhura;</li> <li>• të japë shembuj të llogaritjeve të mesatareve të ponderuara duke konsideruar vlerat e krediteve dhe koeficienteve të tjerë.</li> </ul>	
-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--

<b>FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE KOMUNIKIMIT</b>	
<p><b>Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit</b></p>	<p><b>Literatura</b></p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><b>Mësuesi i arsimit profesional duhet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të njohë rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kodi i Etikës së Mësuesve në Arsimin Parauniversitar publik dhe privat, 2013.</li> <li>• Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të etikës dhe të komunikimit.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>të sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.</li> </ul>	
-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--

FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE	
<b>Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe</b>	<b>Literatura</b>
<b>Rezultatet e pritshme</b> <b>Mësuesi i arsimit profesional duhet:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>të njohë rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe;</li> <li>të zbatojë rregullat e drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Literaturë dhe udhëzues metodikë për përdorimin e rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.</li> </ul>